VENDIM
Nr.427, datë 13.7.2007

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.541, DATË 26.7.2006 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E MODELIT TË PASAPORTAVE DHE PËRMIRËSIMIN E SISTEMIT TË LËSHIMIT TË TYRE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 13 të ligjit nr.8668, datë 23.11.2000 "Për pajisjen e shtetasve me pasaportë për jashtë shtetit", me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.541, datë 26.7.2006 të Këshilit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime e shtesa:

1. Në titull dhe në pikën 1 hiqen fjalët "…dhe përmirësimin e sistemit të lëshimit të tyre".

2. Në lidhjen, që i bashkëlidhet vendimit, të bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Pjesa ku përshkruhet përmirësimi i sistemit të lëshimit të pasaportave shfuqizohet.

b) Në pikën 1.3 "Fleta plastike transparente" të aneksit 2, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

i) Në paragrafin e parë fjalët "...efektet e kinegramës..." zëvendësohen me "...shenja optikisht të variueshme (OVD)...".

ii) Në paragrafin e dytë, ku përcaktohet trashësia maksimale e fletës, numri 6 mikron bëhet 8 mikron.

iii) Në paragrafin e katërt fjalët "...aplikohet kinegramë..." zëvendësohen me "...aplikohen shenja optikisht të variueshme (OVD)...".

iv) Në pikën 1, fjalët "Efektet e kinegramës..." zëvendësohen me "Efektet holografike...".

c) Pas paragrafit të parafundit të pikës 1.4 "Qepja e pasaportës", shtohet një fjali, me këtë përmbajtje:

"Tegeli mund të jetë me nyje bllokuese, për të garantuar qëndrueshmërinë dhe sigurinë e mosshkëputjes së tij.".

ç) Paragrafi i parë i nënndarjes "Shtypi i kapakut" i pikës 2.1 "Shtypi dhe elementet e sigurisë" ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Kapaku i pasaportës së zakonshme do të shtypet me stampim të nxehtë të fletës (foljes) speciale të varakut me ngjyrë ari, ndërsa kapaku i pasaportës së shërbimit dhe i asaj diplomatike do të shtypen me stampim të nxehtë të fletës (foljes) speciale të varakut me ngjyrë argjendi.".

d) Në paragrafin e parë të pikës 2.6 "Qarku i integruar (Chip)" hiqet fjala "të pasmë".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha